

RENDI I DITËS

Projektvendime: “Për shpalljen e moszgjedhshmërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Tiranë, zonjës Dallëndyshe Agim Bici, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.**

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë:

Z. I. Celibashi: Fillojmë seancën në rend të ditës kemi vetëm një çështje “Për shpalljen e moszgjedhshmërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë!

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e mungesës për mbi 6 (gjashtë) muaj rresht në Kuvend, të deputetit zotit Arben Ahmetaj. Referuar nenit 164, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se, në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 12.01.2024*

deputetit, kandidatit të radhës në listën shumemërore të partisë politike përkatëse. Rezulton se lista shumemërore e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste të Shqipërisë”, Qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës. Sipas listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 21, zonja Dallëndyshe Bici. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar kandidatin për deputet për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të figurës së kandidatit. Me shkresën nr. 5111 prot., datë 11.01.2024, kandidati për deputet zonja Dallëndyshe Bici, njoftoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se nuk do të vijojë me procedurat ligjore përkatëse për marrjen e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte, referuar nenit 5, pika 2 të ligjit nr. 138/2015, refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit përbën shkak për mosregjistrimin apo moszgjedhshmërinë e kandidatit si deputet i Kuvendit. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t’u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik. Referuar nenit 11, pika 2 të ligjit nr. 138/2015, konstatohet se kandidati i radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Qarkun Tiranë, nuk do të vijojë me procedurat ligjore përkatëse për marrjen e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, vendosim për:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 12.01.2024*

- Të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Tiranë, zonjën Dallëndyshe Agim Bici.

Do të bëjmë po sot, njoftimin për kandidatin e radhës për zotin Ndrecaj dhe nëse marrim përgjigje brenda ditës së sotme, ose brenda kësaj jave, ditën e hënë do të lemë mbledhjen tjetër të radhës, dakord?!

Mirë, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 06

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

